



DEKLARATË NOTERIALE

Në Tiranë, sot më datë 24.01.2020 (dy mijë e njëzetë), para meje noteres Eriketa KOKOLI, me adresë në Rr. "Sami Frashëri", Pallati i Ri pranë Drejtorisë së Policisë, Kati IV, Tiranë, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqit:

DEKLARUESI: "BANKA e TIRANËS" SH.A, regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.12718, datë 03.11.1995, NIPT J61924008V, që vepron si BANKË me Licensën Nr.07, datë 12.09.1996 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, me seli në Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë, përfaqësuar nga Drejtore e Divizionit të Korporatave, znj. Glenda Kurti, e bija e Agronit, lindur me 06.03.1978, ne Tirane dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. "Kongresi i Manastirit", Pall. ½, Shkalla 3, identifikuar me pasaporte Nr. H85306150N dhe nga Drejtore e Departamentit të Administrimit të Kredive, Aida CENGU, e bija e Azemit, linë më 16.02.1970 në Kukës, banuese në adresën Rr. "M.Fortuzi", Nd.2, H.14, Ap.3 Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit Nr.025225466, të dy madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët deklaruan sa më poshtë vijon:

Shoqëria "BANKA e TIRANËS" SH.A, i ka akorduar Kredimarresit shoqërisë "Hysenbelliu" sh.p.k (NUIS J81813004C) një kredi bankare sipas Kontratë për Kredi Afat Gjatë Nr.957/26.12.2019 me Nr.22Rep/Nr.07Kol datë 08.01.2020 të noteres Eriketa Kokoli, në shumën prej EUR 4.000.000 (katër milion euro).

Per te siguruar shlyerjen e kësaj kredie, është vendosur barrë siguroese dhe peng ne favor te "BANKA e TIRANES" Sh.A mbi aksionet që zotëron z.Alban Xhaferi në kapitalin e shoqërisë "BIRRA TIRANA" SH.P.K (NIPT J61821051F) si më poshtë:

- (i) 162,313 (njqind e gjashtedhjetë e dy mijë e treqind e trembedhjetë) aksione (pjesëve të kapitalit) me vlerë nominale 1,000 Lekë (nje mijë lekë) secila, të zotëruara prej Barrëdhënësit në kapitalin e shoqërisë "Birra e Tiranes" sh.a (NUIS Nr.J61821051F) dhe që përfaqësojnë 14.62% të kapitalit të kësaj shoqërie; si dhe
- (ii) çdo aksion të ri të shoqërisë "Birra Tirana" sh.a që mund të fitohet në të ardhmen prej Barrëdhënësit nëpërmjet kapitalizimit të fitimeve, rritjes së kapitalit etj; si dhe
- (iii) të gjitha të drejtat që rrjedhin në çdo mënyrë, direkt ose indirekt, nga zotërimi i Kolateralit, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në të drejtën e dividendëve (fitimeve) dhe të drejtën e votimit në asamblenë e aksionarëve lidhur me Kolateralin.

Kjo vertetohet me Marrëveshjen Siguroese me Nr. 24Rep e Nr. 9Kol, date 08.01.2020 te noteres Eriketa KOKOLI si dhe Kontratës së Pengut mbi Kuotat me Nr.27Rep/Nr.12Kol datë 08.01.2020 të noteres Eriketa KOKOLI, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me datë 15.01.2020 dhe në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve më datë 13.01.2020.

Meqenese mbi 162,313 (njqind e gjashte dhjetë e dy mijë e treqind e trembedhjetë) aksione pjesë të kapitalit me vlerë nominale 1,000 Lekë (nje mijë lekë) secila, të zotëruara nga z.Alban XHAFERI në kapitalin e shoqërisë "BIRRA TIRANA" SH.P.K (NUIS Nr.J61821051F) dhe që përfaqësojnë 14,62 % të kapitalit të kësaj shoqërie është vendosur barrë siguroese dhe peng ne favor te "BANKA e TIRANES"

SH.A, me këtë deklaratë ne japim pëlqimin për:

- a) kalimin e pronësive së aksioneve dhe respektivisht pjesës prej 14,52% (katërmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e dy përqind) të kapitalit të shoqërisë “BIRRA TIRANA” SH.P.K (NUIS Nr.J61821051F) nga Shitësi z.Alban XHAFERI tek Blerësi shoqëria “HYSENBELLIU” SH.P.K me kushtin që mbi këto aksione të vazhdojnë të qëndrojnë të rënduara me peng dhe barrë siguruese në favor të “BANKA e TIRANES” Sh.a;
- b) lirimin e pengut të regjistruar në favor të “Banka e Tiranës” sh.a në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve, mbi 0,1 % (zero pikë një përqind) të aksioneve që z.Alban Xhaferi zotëron tek shoqëria “Birra Tirana” sh.a pasi këto aksione në masën prej 0,1 % (zero pikë një përqind) do të vijojnë të mbeten në pronësi të z.Alban Xhaferi.

Pra, kalimi i pronësisë së aksioneve në masën prej 14,52 % (katërmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e dy përqind) të zotëruara nga Shitësi z.Alban XHAFERI në emër të Blerësit shoqërisë “HYSENBELLIU” SH.P.K. duhet të bëhet së bashku me barrën siguruese/pengun në favor të “BANKA e TIRANES” Sh.a dhe pa cenuar të drejtën e saj si dhe lirimin nga peng i regjistruar në favor të “Banka e Tiranës” sh.a mbi 0,1 % (zero pikë një përqind) të aksioneve që z.Alban Xhaferi zotëron në shoqërinë “Birra Tirana” sh.a.

Gjithashtu, ne japim pëlqimin tonë për kryerjen e veprimeve perkatëse nga Zyra e Noterise, Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Qendra e Regjistrimit të Aksioneve.

Kjo Deklaratë Noteriale u përpilua nga unë Noteri në 6 (gjashtë) origjinale konform vullnetit të lirë të Deklaruesve, të cilëve pasi ju lexua me zë të lartë dhe pasi e gjetën sipas vullnetit të tyre, e nënshkruan rregullisht para meje NOTERIT.

DEKLARUES

“BANKA e TIRANËS” SH.A.
përfaqësuar nga:


Drejtoreshë e Divizionit të Korporatave


Drejtoreshë e Departamentit të Administrimit të Kredive

NOTERE

ERIKETA KOKOLI

